



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.57/2016

Prishtinë, më 24.5.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Fatmir Rexhepi, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

I ftuar: Enver Halimi, kryesues i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – (ZRRE).

Pjesëmarrës të tjerë: Qemajl Mustafa, Besim Sejfiq dhe Krenar Bujupi –ZRRE, Sabit Gashi, Nezir Myrtaj, Fazile Bekteshi dhe Xhemajl Avdyli – MZHE, Visar Hoxha dhe Kadri Kadriu – KOSTT, Fjolla Uka – KDI, Pranvera Musa – Kosova Press, Florina Ujupi – BIRN, Albulena Mavaraj – Epoka e Re, Adriana Sejfia – GAP; Blerta Bejtullahu – Zyra e BE-së, Dren Ajeti – GLPS dhe Mjellma Kadriu – praktikante.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3.5.2016;
3. Votimi i Pakos së Projektligjeve të energjisë pas komenteve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë;
4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.05/L-079 për Investimet strategjike në Republikën e Kosovës;
5. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-083 për Falimentim;

6. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE për vitin 2015;
7. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Besim Beqaj propozoi që Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-079 për Investimet strategjike në Republikën e Kosovës, të hiqet nga rendi i ditës e të trajtohet në mbledhjen e radhës.

Blerim Grainca propozoi që pika 6 (gjashtë) e rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE për vitin 2015, të kalojë si pikë e 3 (tretë) pasi që e kemi Bordin këtu.

Komisioni u pajtua me propozimet dhe e ndryshoj rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 03.5.2016

Procesverbali nga mbledhja e datës 03.5.2016 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE për vitin 2015

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha se lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kemi marrë një raport mjaft voluminoz të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE-së) ku shihet që ky organ ka aktivitet dinamik pas përbërjes së plotë të Bordit. Ishte një periudhë kur nuk ishte përbërja e plotë e bordit dhe mungesa e tij krijonte vakum institucional në marrjen e vendimeve. Prandaj ky bord ka qenë mjaft i ngarkuar me punë pas përbërjes së plotë, dhe më pas ia dha fjalën z. Enver Halimi, që ta prezantojë shkurtimisht raportin.

Enver Halimi, kryesues i Bordit të ZRRE-së, falënderoi anëtarët e Komisionin për mundësinë e arsytimit të raportit. Ai tha se tani Zyra e Rregullatorit të Energjisë është me përbërje të plotë të Bordit me 5 (pesë) anëtarë, për një kohë të gjatë ka funksionuar me 3 anëtarë gjatë vitit 2014 dhe pastaj deri në muajin gusht. Lënia e punës nga një koleg, bordi nuk ishte funksional. Z Halimi, theksoi se në raport është paraqitur një analizë e aktivitetit të Zyrës së Rregullatorit dhe aktiviteti në sektorin e energjisë gjatë vitit 2015. Raporti është i përfshirë në dymbëdhjetë kapituj sipas lëndëve dhe departamenteve. Raporti përmban informacione të ndryshme të detajuara kryesisht mbi gjendjen e sektorit, nivelin e shërbimeve të ofruara në sektor, ndërmarrjet e licencuara, etj. Veprimtaria e Zyrës së Rregullatorit financohet nga të hyrat vetanake, pra mblidhen nga taksat të përcaktuara sipas ligjit të Rregullatorit të Energjisë dhe buxheti duke u miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ai theksoi se gjatë vitit 2015 kanë pasur disa telashe duke thënë se tashmë janë elaboruar. Te objektivi i Rregullatorit qëllimi është ngritja e kapaciteteve profesionale të ZRRE-së për përmbushjen e sfidave të cilat dalin nga përgjegjësitë tona të cilat janë të parapara me ligjin mbi Rregullatorit të Energjisë dhe sfidat të cilat i kemi

ndaj kërkesave të integritimit në tregun rajonal evropian. Natyrisht duke përfshirë edhe transparencën sa më të madhe që të jetë e mundur edhe ndaj publikut i cili është hulumtimi jonë themelor. Në planin e bashkëpunimit ndërkombëtar rajonal ZRRE-ja t'i kryejë detyrat dhe obligimet e veta ndaj Traktatit të Komitetit të Energjisë përmes Bordit Rregullativ dhe grupeve punuese në kuadër të tij. Është edhe një lajm i mirë për ZRRE-në, më 17.11.2015, Këshilli Evropian i Rregullatorëve të Energjisë na ka pranuar si anëtarë vëzhgues. Mendoj se në këtë rast do të përfitojmë në aspektin rregullativ dhe shkëmbimit të praktikave. Me gjithë arritjet ne mendojmë se ka vend për përmirësim duke punuar më mirë. Kjo bëhet duke u përqendruar te zvogëlimi i humbjeve teknike, ngritja e kapaciteteve të reja gjeneruese, si dhe përmirësimin dhe rritjen e cilësisë ndaj konsumatorëve. Pra, Zyra e Rregullatorit në vazhdimësi ka bërë dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet për të forcuar transparencën dhe profesionalizmin, bashkëpunimin ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit, në mënyrë që veprimtarinë e saj dhe autoritetin vendimmarrës të caktuar nga ligji, duke krijuar një sektor më stabil, të sigurt dhe të besueshëm të energjisë. Barazia ndërmjet palëve në sektorin e energjisë elektrike, po ashtu është obligim ligjor dhe synim i përhershëm i ZRRE-së. Në fund z. Halimi tha se si bord presim sugjerimit, pyetjet, mendimet dhe jemi të gatshëm të përgjigjemi.

Kryetari e falënderoi për raportin dhe tha se janë disa çështje që do t'i diskutojmë, që janë shumë të rëndësishme, humbjet teknike në rrjetin e shpërndarjes e cila mbetet mbrapa dinamikës së paraparë dhe një pjesë është në dëm të KEDS-it e të konsumatorëve dhe mbetet çështje aktuale. Çështja e dytë mbetet dinamika e investimeve sipas kontratës me KEDS-in. Përsëri në raport nuk kemi një analizë të investimeve që janë duke u bërë dhe që janë paraparë, duke thënë se dy vitet e para ka pasur ngecje në zbatimin e kontratës dhe nuk ka informacione se si është duke shkuar puna në vitin e tretë, dhe shtoi se sigurisht se do të kemi informata plotësuese për realizimin e investimeve nga KEDS-i. Çështja tjetër ka të bëjë me bizneset që kanë pasur disa kërkesa lidhur me tarifën, që për biznese është e lartë dhe ankesa lidhur me tarifën verore dhe dimërore që nuk i përshtatet bizneseve edhe pse është bërë një zgjidhje më herët dhe nuk ka hyrë në këtë raport, nuk është përshkruar, sigurisht që është bërë sivjet. Ne e mirëpresim edhe atë, por janë edhe disa çështje të cilat do t'i trajtojmë në vijim. Në përgjithësi në aspektin metodologjik nevojiten disa avancime lidhur me raportet, jo vetëm raporte përshkruese, raportet që vijnë nga agjencitë e pavarura e kanë krijuar një shabllon, model duke i përshkruar gjërat e më pak i analizojnë problemet me të cilat ballafaqohen. Neve na nevojitet që të kemi analiza për problemet e caktuara.

Raif Qela tha se raporti i ZRRE-së, i vitit 2015, është përpiluar në përputhje me kërkesat e bashkëpunimit të agjencive të pavarura institucioneve dhe si e tillë në përgjithësi mendoj se nuk ka vërejtje. Megjithatë, këtij raporti i mungojnë disa gjëra të cilat do të duhej të ishin këtu. Meqenëse në dhjetor të vitit 2015 është kompletuar Bordi, megjithatë ky bord nuk e ka aq shumë peshën e përgjegjësisë edhe nëse mungon diçka në këtë raport, sepse nuk është përgjegjës për pjesën e bërë të punës gjatë vitit 2015. Lidhur me humbjet komerciale, sidomos në Mitrovicë, do të kisha dashur ta dija pse kjo shifër është aq e lartë në krahasim me komunat e tjera. A ka të bëjë kjo me pjesën veriore të Kosovës, si rajon që i përket komunës së Mitrovicës, apo ka edhe biznese të tjera për shkak të cilave ka humbje të shumta komerciale. Si ka ndikuar mungesa e bordit në kryerjen e detyrave të Zyrës për Rregullatorin e Energjisë. Pse ka numër aq të madh të konsumatorëve të cilëve nuk kanë arritur t'i zgjidhen ankesat, sepse janë mbi 25% të ankesave të cilat nuk kanë marrë një përgjigje. Lidhur me çështjen e financimit të ZRRE-së dhe

problemit rreth financimit të ZRRE-së. Pastaj, tarifat e energjisë për konsumatorët jo amvisëri siç e përmendi edhe kryetari i Komisionit, sa do të mund të harmonizohet kjo në mënyrë që bizneset ta kishin më të lehtë funksionimin e tyre, të harmonizoheshin me ato të konsumatorëve amvisërorë. Në qershor është eksportuar shumë energji, janë gjithsej 157 779 MV energji. Pse ka pasur nevojë të importohet pikërisht në muajin që ka pasur më së shumti eksport. Cili është shkaku? Pastaj në tabelën faqe 77, tabela përmban çështje të ndryshme të pabashkëmatshme. Kjo është tabela në të cilën janë pasqyruar bashkë me performancën energjetike të Termokosit duke treguar sa megavat orë energji janë prodhuar për bruto prodhimin e neto prodhimin etj. Janë futur edhe humbjet në transport dhe prodhim edhe humbjet në përqindje që nuk e kanë vendin aty sepse këto janë çështje të pabashkëmatshme përderisa humbjet në përqindje janë deri në 100 %. Jepet pasqyra se humbjet qenkan tepër të vogla e në të vërtetë nuk është ashtu. Kjo tabelë duhet të ndryshohet. Nuk e kanë vendin aty sepse krijojnë paqartësi, hutë. Rreth 150 megavat orë, ku gjenerimi është ndihmesë për plotësimin e nevojave për energji. Si do të ndikonte po të zgjerohej rrjeti i qasjes për furnizim me nxehtësi edhe në komunat e tjera. Sa do të ndikonte kjo në siguri të furnizimit. Sa do të ndikonte në çmimin e energjisë, meqenëse kjo do të ulte shfrytëzimin e energjisë elektrike për konsumatorët në përgjithësi në Kosovë.

Besim Beqaj tha se raporti si i tillë është raport standard i cili sipas metodologjisë të cilin e kemi parë paraqet disa tarifa dhe sfida që realisht na paraqiten në proces. Por, do t'i referohem pak takimit që kishim para ca ditësh me përfaqësuesin, respektivisht me drejtorin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, z. Kopac. Ne, si Komision, kishim një takim dhe në drejtim të përmbushjes së obligimeve që kemi në raport me Traktatin e Energjisë, dhe në drejtim që të krijohen më shumë mundësi për energjinë e ripërtërishme dhe harmonizimin e investimeve të reja, duke mundësuar edhe planifikimin e shfrytëzimit të resurseve që i kemi. Ishin çështje të cilat i kemi diskutuar dhe besoj që edhe ju i keni biseduar me ta. Por nga këndvështrimi jonë do të kishim dashur me ditur cila është procedua, apo çka po ndodh te plotësimi apo harmonizimi i licencimeve për energjinë e ripërtërishme, meqenëse aty i kemi ato tarifat e sponsoruara. Unë e kam parë që keni marrë një vendim së fundi që është jashtëzakonisht i rëndësishëm, me të cilin tenton që ta ulë nevojën për prodhimin e energjisë elektrike e cila rrjedh nga fosilet. Njëkohësisht aty një nga obligimet është edhe liberalizimi i tregut. Sekretariati ka një shqetësim. Besoj që ju jeni në ngjarje më shumë se ne dhe ajo ka të bëjë me liberalizimin e tregut, respektivisht kërkesat për furnitorë të mëdhenj të cilët do të duhej të kishin mundësi të zgjedhin furnitorin e tyre me energji elektrike. Këtu kjo konsiderohet se është lënë anash dhe besoj që kjo parimisht jep informatën dhe arsyen pse çështja e tillë ka ndodhur. Në të njëjtën kohë do të ishte mirë për Komisionin, por edhe për publikun të na njoftonit për tarifat dhe sistemin e tarifave, respektivisht investimet të cilat do të duhej të bëheshin dhe ndikimet e tyre në tarifat të cilat paraqiten, sepse po flasim për investime dhe ju i matni edhe investimet e prodhuesit edhe të distributorit edhe investimet e tyre të cilat do të duhet pastaj të përdoren në këtë proces. Por fokusi do të ishte që ne, në parim, t'i kalojmë ligjet, besoj që do t'i kalojmë ligjet për energjinë, t'i çojmë në Kuvend, që ka qenë obligim edhe pse kemi një vonesë në këtë drejtim. Janë ligje, të cilat besojmë se janë të mira, por që kërkohet një angazhim më i madh i Rregullatorit për liberalizimin e tregut.

Blerim Grainca tha se edhe shqetësimet kryesore të mia kanë të bëjnë me burimet e ri përtëritshme, gjegjësisht me të dhënat që janë paraqitur në këtë raport dhe në veçanti me numrin e licencave që janë dhënë për këtë. Më intereson të dijë, sepse kam parë në raport se një numër i licencave janë bartur edhe pse nuk janë realizuar, ata që i kanë marrë licencat nuk i kanë kryer punimet i janë vazhduar licencat për një afat të caktuar. Pse ka ndodhur kjo? Sepse unë po i referohem praktikave në rajon dhe e dini se në shumicën e vendeve të rajonit ka qenë një dukuri dhënia e licencave, pastaj stërshitja e tyre. A po ndodh edhe kjo te ne? A po jepen licencat vetëm sa për të dhënë licenca apo për t'i bartur apo transferuar te palët e treta apo po realizohen sipas lejeve që janë marrë. Po ashtu një pyetje konkrete lidhet me një hidrocentral në lumin Lebenc, sepse unë kam pasur disa vërejtje dhe ankesa nga qytetarët. A është bërë kjo sipas rregullativës ligjore në fuqi, dhe a ndikon në rrjedhën e lumit dhe në ndryshimet të tjera ambientale që ndodhin, për arsye se shqetësimet kanë qenë të kësaj natyre. Pyetja ime e tretë ka të bëjë me tabelën ku i referohen investimet që kanë ndodhur në Korporatën Elektro - energjetike, gjegjësisht në KEK. Në bazë të dhënave që kemi aty p.sh. nga investimet e parapara dhe të lejuara në Miniera janë realizuar vetëm 13 %. Ky 13% po i ri kontribuon rritjes së kapaciteteve për prodhimin e energjisë, e në veçanti, kur kihet parasysh se të gjitha këto investime prej 13 %, janë lejuar investime kapitale. Në kuadër të investimeve kapitale janë bërë furnizime, janë blerë ekskavatorë, janë blerë buldozerë. Që në fakt ndikojnë në renovimin dhe përmirësimin e gjendjes në minierat tona. Po ashtu, në Kosovën B kemi vetëm 21 % realizim të investimeve të lejuara. A i ka mbikëqyrur këto ZRRE-ja dhe cilat janë arsyetimet dhe arsyet që kemi pasur ngecje të tillë?

Duda Balje kërkoi sqarime lidhur më projektin e hidrocentralit të Zhurit se a janë respektuar procedurat e marrjes së lejes nga komunat përkatëse Prizreni dhe Dragashi? Sepse nuk ka pasur as diskutim publik. Pasi që popullsia e këtij rajoni janë kundër ndërtimit të hidrocentralit, tha që Kosova ka obligim për energji me hidrocentrale, por qytetarët po janë kundër. Ajo theksoi se janë konsultuar më Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, por ata na kanë thënë se dokumentacioni është në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë.

Qemajl Mustafa, (ZRRE), duke u përgjigjur pyetjeve, për humbjet teknike, tha që në rregullimin që ka bërë ZRRE-ja humbjet janë paraparë të rregullohen në secilin sektor veç e veç! Tani operatori i licencuar për distribuim dhe furnizim të energjisë elektrike, e që është kompania "KEDS" për fat të keq nuk ka arritur t'i zvogëlojë humbjet teknike sa janë të parapara me kontratë. Për investimet në rrjetin e distribuimit nga KEDS nuk janë duke ndodhur brenda afatit që është shkruar në kontratë, por ka investime, po jo në masën e kënaqshme, ndërsa për humbjet teknike po punojmë vazhdimisht, në këtë rast ZRRE-ja është vetëm mbikëqyrës i rregullatorit. Për humbjet e tjera që i ka lejuar ZRRE-ja janë në tarifa që në këtë rast si ndërmarrje publike "KOSTT" ka arritur suksese në sistemin e transmisionit, ndërsa në sistemin e shpërndarjes ka pasur ngecje. Lidhur me tarifat për bizneset, tha që kemi diskutuar në Bordin e ZRRE-së dhe i kemi bartur të gjitha tarifat teprice në mënyrë që të ju ndihmojmë bizneseve. Për liberalizimin e tregut në furnizimin dhe shpërndarjen energjisë elektrike, tha që kjo duhet të bëhet më ligjet që janë në fuqi, por kjo nuk është bërë deri më tani për shkak të barrierave që i kemi nga shteti i Serbisë. Ky është një problem politik që po na pengon Serbia.

Besim Sejfiqaj, ZRRE, ju përgjigj pyetjeve, për autorizimet preliminare që i jep ZRRE-ja, tha se kjo është bërë për shkak të procedurave të shkurtra. Për ndërtimin e hidrocentraleve, për

çështjen e ujërave është përgjegjëse Ministra e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kjo ministri jep leje për shfrytëzimin e ujit, ndërsa komunat japin leje për ndërtim, lidhur me ndërtimin e hidrocentralit të Zhurit, tha se ky është një vendim i lëshuar shumë më përpara dhe ZRRE-ja nuk ka bazë ligjore me penguar këtë projekt.

Krenar Bujupi, ZRRE, për emërimin e drejtorit menaxhues të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, tha që kjo është bërë për nevojat e organizimit të brendshëm të administratës. Me arsyen që bordi i ZRRE-së ta ketë një pikë menaxhuese nga drejtori dhe nuk ka kompetenca në vendimmarrjen e politikave të rregullatorit, por këto kompetenca i ka bordi i ZRRE-së. Për humbjet, tha që janë të lejuara sipas ligjeve në fuqi, se tani për tani e kemi për zgjedhur KEDS-in, por që ende nuk ka arritur t'i përmbush objektivat e caktuara. Për investimet kapitale, tha që caktohen për 5 vjet, ndërsa për KEK-un kemi për 4 vjet. Për ngrohje nga ndërmarrja publike "Termokos" deri tani nuk kemi mundur t'i caktojmë tarifën për këtë shërbim të furnizimit me ngrohje, por këtë vit do t'i caktojmë tarifën. Ai tha se humbjet janë më të mëdha në Mitrovicë, shkakton ndoshta mund të jenë nga shkalla e ulët e kontrollit dhe problemet që tani dihen që janë politike në veri të Mitrovicës. Për importin dhe eksportin e energjisë elektrike, tha që kemi gjatë gjithë vitit, është një çështje që varet nga prodhimi i KEK-ut dhe importi dhe eksporti i energjisë elektrike ndodh në periudha të ndryshme. Për tarifën është vendosur të fillojë eliminimi i ndërsbvencioneve.

Raif Qela kërkoi nga anëtarët e bordit të ZRRE-së që të merrte përgjigje lidhur me numrin e ankesave se sa janë shqyrtuar? Edhe sa do të ndikojë ngrohja nga Termokos-it me kogjenerim edhe në komunat fqinje në uljen e tarifave të energjisë elektrike?

Qemajl Mustafa, ZRRE, iu përgjigj pyetjeve, dhe tha se ankesat i kemi në dy nivele, së pari duhet të bëhet ankesa në KEDS, pasi të marrin përgjigje nga KEDS-i. Pastaj konsumatorët, nëse janë të pakënaqur, mund të ju drejtohen edhe ZRRE-së. Numri më i madh që ka mbetur i ankesave pa shqyrtuar ende është në KEDS, ndërsa shkalla e dytë për ankesa nga konsumatorët mbetet ZRRE-ja.

Kryetari theksoi se numri prej 6 000 ankesave të pa shqyrtuar është numër shumë i lartë, kështu që ju si ZRRE- që jeni rregullator duhet të kërkoni dhe t'i bëni presion KEDS-it që t'i shqyrtojë sa më shpjet ankesat e konsumatorëve.

Sala Berisha-Shala theksoi se raporti është i mirë në bazë të standardeve të kërkuara. Lidhur me humbjet që duhet të gjendet zgjidhje përmes ligjit, tha se nëse planifikohet që më ligj të rriten apo zvogëlohen humbjet, ju si rregullator duhet të jepni zgjidhje se si të rregullohet kjo çështje. Për çështjen e KEK-ut për minierat tha se për këtë çështje mund të bashkëpunoni me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

Besim Beqaj tha se çështja e rregullimit të humbjeve teknike të energjisë elektrike nuk i takon rregullimit më ligj, por kjo çështje lidhet drejtpërdrejt nga ZRRE-ja.

Duda Balje përsëri pyeti se a janë respektuar procedurat e projektit për ndërtimin e hidrocentralit të Zhurit. Ajo tha se është njoftuar nga Drejtoria e Urbanizimit të komunës

përkatëse se MZHE-ja, si hartues i projektit, nuk ka konsultuar as banorët e këtij rajoni për të marrë mendimin sepse dëmtohen pronat e tyre.

Besim Sejfiqaj, ZRRE, tha se lejet ujore nuk i jep ZRRE-ja, por Ministra e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunat japin lejen e ndërtimit sipas procedurave.

Kryetari kërkoi nga ZRRE-ja që për çështjet ngritura nga znj. Balje, të shikohet se a ka pasur shkelje të procedurave.

Pas debatit Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), për vitin 2015, me rekomandimet si vijon:

- *Në raportet vijuese, të rritet niveli i analizës së gjendjes në sektor;*
- *Ecuria në investime në të gjitha organizatat, të prezantohet më hollësisht, duke përfshirë edhe ngecjet në realizimin e tyre. Obligohet Bordi i ZRRE-së, që për këtë pikë ta informojë Komisionin me raport të veçantë, brenda një muaji pas miratimit të këtyre rekomandimeve;*
- *ZRRE-ja të analizojë një zgjidhje më të mirë lidhur me tejkalimin e problemit të ngarkimit të çmimit për konsumatorët e përgjegjshëm, me humbjet komerciale, përkatësisht më borxhet e këqija;*
- *ZRRE-ja të analizojë vonesat në trajtimin e ankesave të konsumatorëve në KEDS;*
- *ZRRE-ja të ketë në dispozicion tërë dokumentacionin përcjellës, në lidhje me licencimin e operatorëve të rinj.*

4. Votimi i Pakos së Projektligjeve të energjisë pas komenteve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë

Muhamet Mustafa, kryetar, tha se lidhur me këto projektligje i kemi diskutuar në mbledhjen e grupit punues gjerë e gjatë dhe amendamentet janë hartuar, duke pasur parasysh edhe komentet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe e keni parë raportin. Kryetari i njoftoi deputetët se ndërkohë edhe z. Qela ka propozuar disa korrigjime teknike të cilat janë inkuorporuar në amendamente.

Raif Qela tha se gjatë shqyrtimit të vërejtjeve që na i ka dhënë Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (SKE), ne, si grup punues, na janë përvjedhur dy-tri gabime. Lidhur me Projektligjin për energjinë elektrike, disa komente të rëndësishme të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë nuk i kemi përfillur dhe jam i bindur se duhet të përfillen. Tek Amendamenti 1, Neni 3.1.26, përkufizimin e termit “Konsumator jofamiljar” e kemi keq, sepse nuk është në përputhje me direktivat. Unë propozoj se këtë term duhet ta përkufizojmë kështu: 1.23. Konsumator jofamiljar – person fizik a juridik që blen energji elektrike të cilën nuk e shfrytëzon për nevoja të veta familjare, e ku përfshihen edhe prodhuesit dhe blerësit me shumicë; dhe ky ndryshim duhet t'i përfshijë të katër projektligjet nga pakoja e ligjeve të energjisë, natyrisht, aty ku këta

terma përmenden. Në takimin e 16 majit nuk është dashur që ta përfillim vërejtjen e SKE-së lidhur me Nenin 19, paragrafi 5 të Projektligjit bazë, si pasojë e vërejtjeve të së cilës u formulua Amendamenti 25. Lidhur me prokurimin e shërbimeve ndihmëse, *Neni 19 Tregu i energjisë elektrike*, duhet të mbetet versioni paraprak i nenit të përmendur të Projektligjit bazë, sepse ne nuk kemi treg të organizuar dhe kush e di edhe sa vite do të shkojnë derisa të bëhet i tillë. Konsiderojmë se duhet të mbetet formulimi fillestar ku përcaktohet se ZRRE miraton procedurat e prokurimit të shërbimeve ndihmëse në bazë të parimeve të transparencës dhe efikasitetit të kostos, dhe se e njëjta mbikëqyret nga ZRRE, dhe se këto procedura propozohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe miratohen nga ZRRE. Konsiderojmë se me versionin fillestar nuk paragjykohet se në cilin lloj të tregut, ku dhe si do të sigurohen shërbimet ndihmëse. Prandaj është më mirë që këtë nen të Projektligjit ta lëmë në versionin fillestar.

Pas diskutimit, Komisioni njëzëri, nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjeve të energjisë;*
- 2. Raporti t'iu procedohet komisioneve të përhershme sipas procedurës.*

5. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-083 për Falimentim

Kryetari, Muhamet Mustafa, njoftoi se Komisionet e përhershme kanë shqyrtuar Projektligjin nr.05/L-083 për Falimentim dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional dhe nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje apo propozim dhe këtë Projektligj duhet ta procedojmë për lexim të dytë sipas procedurës.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit nr. 05/L-083 për Falimentim;*
- 2. Raporti me Rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.*

5. Të ndryshme Çështje vijuese

a) Organizimi i punëtorisë për Projektligjin për Rregullat e Komunikacionit Rrugor

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha se Grupi punues për Projektligjin për Rregullat e Komunikacionit Rrugor, ka kërkuar që të organizojë punëtori, pas që ky Projektligji është mjaft voluminoz. Në këtë punëtori është paraparë që të marrin pjesë hartuesit projektligjit nga Ministra e Infrastrukturës dhe institucionet që kanë të bëjnë zbatimin e Rregullave të

Komunikacionit Rrugor, andaj po kërkohet një vendim formal nga Komisionin për lejimin e kësaj punëtorie.

Komisionin u pajtua me këtë propozim.

b) Informatë për vizitën në Holandë

Kryetari Muhamet Mustafa i njoftoi se është përgatitur informata e delegacionit të Komisionit rreth vizitës në Hagë, Holandë, 3-5 prill 2016, lidhur me pjesëmarrjen në Konferencën Ndërparlamentare, me temë: “Energjia, Inovacioni dhe Ekonomia Ricikluese” dhe mund ta keni s’i njoftim.

c) Ftesë për Projektligjin për Trepçën

Kryetari, Muhamet Mustafa, e njoftoi Komisionin se jemi në përmbyllje të rasteve studimore për Trepçën dhe tani ne konsultim më Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin do ta organizojmë një tryezë, ku janë të ftuar të gjithë anëtarët e Komisionit, si dhe grupi i punës për hartimin e projektligjit për Trepçën. Në këtë takim pritet të marrin pjesë edhe ekspertët e jashtëm të angazhuar për studimin e rasteve të ngjashme me Trepçën. Ky takim mbahet më 4 qershor 2016, prej orës 10:00. Për të gjitha detajet e tjera, lidhur më ftesën dhe agjendën, do të njoftoheni më kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa